



# Programi i elektro-energjetikës

ALBANSKA

**Programi i elektro-energjetikës është një program profesional i cili ju çon deri te diploma profesionale.**

Programi i elektro-energjetikës i'u drejtohet ju që dëshironi të punoni me instalime elektrike, sisteme të automatizuara prodhimi, teknikë uji – energjie dhe ambienti, ose kompjuter e komunikim.

Ju keni mundësi të filloni punën menjëherë pas kryerjes së shkollës, ose të studioni në ndonjë shkollë të lartë profesionale. Gjithashtu, ju keni mundësi të zgjedhni kurse ekstra për të studiuar më tutje në shkollë të lartë.

## KATËR DREJTIME TË NDRYSHME

### Automatizëm

- Ju do të mësoni rreth elektroteknikës, teknikë kompjuteri, teknikë e punës dhe e mirëmbajtjes. Ky drejtim u jep mundësi punësimiti, si p.sh. teknik automatizmi në kuadër të objekteve ndërtimore, industrisë dhe proceseve.

### Teknika e komunikimit dhe e kompjuterit

- Ju do të mësoni të instaloni, administroni, dhe reparoni sisteme për komunikim dhe kompjuter. Ky drejtim u jep mundësi punësimiti, si p.sh. teknik i prodhimeve elektroteknike, teknik i servisit shtëpiak, teknik rrjeti.

### Teknika e elektricitetit

- Ju do të mësoni të instaloni dhe reparoni stabilimente elektrike, alarme dhe sistem tv-je dhe kompjuteri. Ky drejtim u jep mundësi punësimiti, si p.sh. teknik instalimi, elektrikist industrie dhe teknik sinjali e rryme në hekurudhë.

### Teknika e energjetikës

- Ju do të mësoni rreth punës dhe funksionit të servisit në kuadër të sektorëve; energji, ambient, ujë dhe procese. Ky drejtim u jep mundësi punësimiti, si p.sh. operator pune, në kuadër të teknikës së ngrohjes dhe energjisë dhe operator pune në kuadër të teknikës së ambientit dhe e ujit.

## Këto gjëra do t'i mësoni në këtë program

Ju do të mësoni rreth prodhimit, instalimit dhe distribuimit të sistemeve për rrymë, energji dhe ujë. Ju do të mësoni poashtu rreth teknikës elektro – energjetike, automatizëm, teknikës së komunikimit dhe kompjuterit dhe infrastrukturës së teknologjisë së informimit. Ju do të studioni çështje të sigurisë si standarde dhe sigurinë e informimit.

Në këtë program rëndësi të posaqme u kushtohet çështjeve që kanë të bëjnë me ambientin e punës, për t'iu ikur lëndimeve në punë si dhe për të krijuar një shëndet të mirë.

### **Programi është i hartuar në këtë mënyrë**

Në shkollat e mesme profesionale, lëndët e përbashkëta të arsimit të mesëm janë: gjuha angleze, historia, edukata fizike dhe shëndeti, dituri natyre, dituri religjioni, dituri shoqërore, gjuhë dhe letërsi suedeze dhe suedishtja si gjuhë e dytë. Në programet profesionale ju do të mësoni më shumë lëndë profesionale, të ashtuquajtura lëndë specifike e më pakë lëndë që i keni pasur në shkollën filllore.

Lëndë specifike të përbashkëta të këtij programi janë: Teknika e komunikimit dhe e kompjuterit, elektroteknika, teknika e energjetikës dhe elektro-mekanikë.

Ju e keni mundësinë të specializoheni dhe të zgjeroheni edhe me shumë brenda këtij programi profesional. Një gjë e tillë quhet, thellim në program. Pyetni shkollën se cilat lëndë thellimi ju ofronë ajo.

Ju e keni poashtu edhe përzgjedhjen individuale, ku ju vetë zgjedhni cilat lëndë doni t'i mësoni. Pyetni shkollën se cilat kurse i posedojnë.

### **Format e punës**

Ky program pikënisjen e ka te problemet e ndryshme praktike, zgjidhjen e të cilave e bëni bashkarisht apo në mënyrë individuale në mënyrë sistematike dhe me ndihmën e llogaritjeve matematikore. Ju do t'i ushtroni aftësitë t'uaja për të bashkëpunuar me të tjerë, pritjen e myshterinjëve dhe të punoni si në ndonjë firmë ashtu edhe në shtëpi private. Ju do të ushtroni të planifikoni, dhe vlerësoni një proces pune.

### **Punim përfundimtar i shkollës së mesme**

Në përfundim të programit të elektro-energjetikës, ju duhet të përpiloni një punim të shkollës së mesme, brenda lëmisë së profesionit t'uaj të zgjedhur, ku do të dëshmoni se jeni pajisur me ato dituri që u nevojiten për të filluar punën në atë drejtim për të cilin jeni arsimuar.

### **Të mësuarit në vend pune**

Disa pjesë të mësimit zhvillohen në një apo më shumë vende të punës, më së paku gjatë 15 javëve të mësimit dhe quhet të mësuarit në vendin e punës. (suedisht: APL). Kjo është një pjesë përbërëse shumë me rëndësi e shkollimit t'uaj. Apl u jep përvoja dhe kontakte të shumta për të cilat do të keni nevojë kur të kërkonti punë.

### **Trajnim shëgertësh**

Në kuadër të këtij programi keni mundësi të zgjedhni trajnim shëgerti të nivelit të arsimit të mesëm. Kjo do të thotë se ju do të përfitoni dituri të njëjta, por kjo kërkon që së paku gjysma e mësimit duhet të kryet në një apo disa vende pune.

### **Mendohuni mirë**

Nëse doni t'a përfitoni kompetencën themelore për arsim të lartë, është e rëndësishme që t'i planifikoni studimet t'uaja. Në këtë rast ju duhet t'a shfrytëzoni përzgjedhjen individuale si dhe ju do të keni nevojë të mësoni një program më të zgjeruar. Pra i'u duhet të mësoni edhe dy kurse tjera të gjuhës suedeze apo suedishtja si gjuhë e dytë si dhe një kurs të gjuhës angleze. Mos hezitoni të flisni me një këshilltar të orientimit arsimor dhe profesional nëse dëshironi të studioni më tutje.

Ju keni gjithmonë të drejtë që në kuadër të përzgjedhjes individuale, të zgjedhni një kurs më shumë në edukatë fizike dhe shëndet dhe një lëndë estetike.